



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

Nr. 28 Prot

Tiranë, më 13.05.2013

VENDIM Nr. 17 dt. 10.05.2013

Në mbështetje të nenit 17, pika 6, të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, ndryshuar me ligjin nr. 9882, dt 28.02.2008, "Për Trashëgiminë Kulturore", Këshilli Kombëtar i Restaurimeve në mbledhjen e datës 10.05.2013, pasi shqyrtoi projektet e diskutuara në Institutin e Monumenteve të Kulturës, sipas pikave të rendit të ditës:

VENDOSI:

1. **Miratohet:** Projekt Restaurimi dhe integrimi i banesës "Kristo Rapo", në banesën Kadare, Gjirokastrë.
2. **Miratohen në parim:** Projekt restaurimi i 6 çative në qytetin e Gjirokastrës. **Projekti duhet të detajohet sipas standarteve të kartës së restaurimit dhe të dërgohet për siglim pranë IMK.**
3. **Miratohet:** Projekt restaurimi Hamami i Meçites, Gjirokastrë.
4. **Miratohet varianti me dru dhe me xham për:** Projekt rikonstruksion i trotuarit dhe ndërtimi i qendrës së informimit turistik në sheshin e Çerciz Topullit, Gjirokastrë.
5. **Miratohet:** Projekt restaurimi i objektit ëmbëltore "Festivali", me investitor Qirjako Dhima, Gjirokastrë.

- Ngarkohet sekretaria teknike, për njoftimin e këtij vendimi.
- Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR  
VISAR ZHITI

SEKRETAR I KKR  
AKADEMIK. APOLLON BAÇE